



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALMA XH. XHURA  
ADRESA NR.3, QEMAL STAFA  
TEL:

# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 7951

Tirane më 26/12/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053280477019901

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ALMA XH. XHURA



DATE 26/12/2023  
NR REP 7951

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 26.12.2023, para meje Notere ALMA XH. XHURA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.3, QEMAL STAFA, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Gezim Gjoni, atësia Sali, amësia Sabrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Qemal Stafa; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 22/02/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032569664 dhe nr. personal G50222049U, .

Subjekteti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ERGJ Construction" shpk, dokumenti origjinal bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ALMA XH. XHURA

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ERGJ Construction" shpk.  
KREUI

Ne Tirane, sot me date **26.12. 2023** (dymije e njëzetë e tre), une i nenshkruari i meposhtem Gezim Gjoni, atësia Sali, amësia Sabrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Qemal Stafa; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 22/02/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Letërnjoftim ID nr. 032569664 dhe nr. personal G50222049U

*me cilesine e "Ortakut Themelues", redaktoj kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "ERGJ Construction" shpk.*

KREUI  
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1  
Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "ERGJ Construction" shpk.

Neni 2  
Forma Juridike

Shoqëria "ERGJ Construction" shpk., është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpermendur, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "ERGJ Construction" shpk., është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku I vetëm që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në **Tirane, rruga "Pjetër Budi" nr. 61**



Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakur të Vetem të shoqërisë.

#### Neni 4

##### Objekti

Ndërtim, montim, zhvillim, zbatim për ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe të ulët, rikonstrukcione objektësh, prodhimin dhe tregëtimin e materialeve të ndërtimit, import eksport me pakicë dhe shumicë të mallrave ushqimore, industriale, bujqësore, tregëtim karburantësh dhe të vajrave lubrifikante të të gjitha llojeve. Bar kafe. Administrim dhe mirembajtje e ndërtësive të banimit. Palester gjimnastikore e aktivitete të ndryshme sportive.

#### Neni 5

##### Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

### **KREU II , KAPITALI**

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 lekë (njqind mije)** dhe është i perbere nga **1 kuote**. Kapitali i mesiperm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakuri i vetem i shoqërisë perkatesisht :

Erjon Bastari,, zoterues i 1 kuote, me vlerë të pergjithshme **100 000 Leke (njqind mije)**, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakurit të vetem mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 9**

#### **Marrja e vendimeve**



Ortaku i vetem për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votimin e tij. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### Neni 10

##### Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **Gezim Gjoni**, i cili do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetecare me të drejtë ripërteritje.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### Neni 11

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asamblëja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e

juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 13

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto raste Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

#### Neni 14

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 15

##### Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### Neni 16



Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues te shoqerise tregtare "**ERGJ Construction**" *shpk.*, i cili deklaroi se ka lexuar e kuptuar gjithcka ne lidhje me kete statut dhe e nenshkruan rregullisht ate ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet Erjon Bastari, per depozitim te ketyre akteve prane QKR.

**ORTAKU I VETEM**

**GEZIM GJONI**

Gezim Gjoni  
  
